

VENDIM
Nr. 745, datë 4.12.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR
PAJISJEN ME LICENCË TË SIPËRMARRËSVE, QË OPEROJNË NË TREG ME
GAZET SERRË TË FLUORUARA DHE PAJISJET QË PËRMBAJNË KËTO GAZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 2/2023, “Për gazet serrë të fluoruara”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dokumentacioni i nevojshëm për pajisjen e sipërmarrësit me licencën, që përfshihet në kategorinë III.3.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, ngarkohet gjatë aplikimit në portalin unik qeveritar “e-Albania” dhe është, si më poshtë vijon:

a) Për licencën me kodin III.3.B.1:

i. autorizimi, që vërteton se personi, i cili paraqet kërkesën në emër të subjektit, kur ky nuk është titullari i subjektit, është i autorizuar prej këtij subjekti për të kërkuar licencën dhe për të bërë deklaratimet e kërkuara në emër të subjektit;

ii. kontrata e lidhur ndërmjet sipërmarrësit dhe drejtuesit teknik në fushën e veprimtarive me gazet serrë të fluoruara dhe pajisjet që përmbajnë këto gaze;

iii. diploma për arsimin e mesëm ose të lartë të drejtuesit teknik;

iv. dokumenti i pronësisë ose kontrata e përdorimit të mjediseve, ku sipërmarrësi do të operojë me gaze serrë të fluoruara ose pajisje që përmbajnë këto gaze;

v. vetëdeklarimi mbi përshtatshmërinë e mjediseve për importin, eksportin, magazinimin e gazeve serrë dhe të pajisjeve që përmbajnë këto gaze, që lidhet me sigurimin e sistemeve të përshtatshme të ventilimit, të sigurisë nga zjarri dhe të kushteve të magazinimit të përshtatshme për të trajtuar gazet nën presion.

b) Për licencën me kodin III.3.B.2:

i. Autorizimi, që vërteton se personi, i cili paraqet kërkesën në emër të subjektit, kur ky nuk është titullari i subjektit, është i autorizuar prej këtij subjekti për të kërkuar licencën dhe për të bërë deklaratimet e kërkuara në emër të subjektit;

ii. diploma për arsimin e mesëm ose të lartë të drejtuesit teknik;

iii. vetëdeklarimi në rastin kur sipërmarrësi kryen vetë funksionet e operatorit dhe është person i certifikuar, shoqëruar me certifikatën përkatëse;

iv. vetëdeklarimi në rastin kur sipërmarrësi kryen vetë funksionet e operatorit, por nuk është person i certifikuar; në këtë rast, vetëdeklarimi shoqërohet edhe me kontratën e punës dhe certifikatën e personit të kontraktuar;

v. kontrata me operatorin, në rastin kur sipërmarrësi nuk është operator, si dhe kontrata me personin e certifikuar, të shoqëruar me certifikatën përkatëse;

vi. dokumenti i pronësisë ose kontrata e përdorimit të mjediseve, ku sipërmarrësi do të operojë me gaze serrë të fluoruara ose pajisje që përmbajnë këto gaze;

vii. vetëdeklarimi mbi përshtatshmërinë e mjediseve për vendosjen në treg të pajisjeve, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara dhe/ose gazeve serrë të fluoruara, në funksion të instalimit, të shërbimeve, të mirëmbajtjes ose të riparimit të pajisjeve të gazeve serrë dhe të pajisjeve, që përmbajnë këto gaze, që lidhet me sigurimin e sistemeve të përshtatshme të ventilimit, të sigurisë nga zjarri dhe të kushteve të magazinimit të përshtatshme për të trajtuar gazet nën presion.

2. Sipërmarrësi, që kërkon të pajiset me licencën me kodin III.3.B.2, aplikon kur veprimtaria kryhet në funksion:

a) të kryerjes së instalimit, të shërbimeve, të mirëmbajtjes ose të riparimit të pajisjeve, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet mbi ato gaze;

b) të vendosjes në treg të pajisjeve të mbyllura johermetikisht, të mbushura me gaz serrë të fluoruar.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama